

Bullying: Incidence, Impact, and Intervention

Ph.d Candidate Fitnet Hasekiu

**“ Aleksander Xhuvani” University
Faculty of Education Sciences
Department of Psychology
Elbasan, Albania
neta_hasekiu@yahoo.com**

Abstract

Bullying is generally defined as repeated negative actions (i.e., physical, verbal, and/or psychological) directed at a target over time, where there is a power differential (either real or perceived) between the target and the bully/bullies.

The widespread and chronic nature of bullying suggests that the impact on children both short and long-term can be considerable.

When bullies are allowed to engage in aggressive behavior at a young age, without effective intervention from parents and / or school system, they are at significantly greater risk for negative outcomes later in life.

Developmental models (e. g., social – learning, and social cognitive theory) are supported by longitudinal research, which indicates that early interventions is critically important in preventing the development of aggressive and antisocial behavior patterns. If we do not intervene with bullies, we do not only place targets at risk for physical injury, depression, anxiety, and low self esteem, but also significantly increase the likelihood that bullies develop into antisocial adults.

While intervention against bullying is particularly important to reduce the suffering of the victims, it is also highly desirable to counteract these tendencies for the sake of the aggressive students, as bullies are much more likely than other students to expand their antisocial behaviors.

Work with parents should begin initially with education about the importance of changing the bully’s behavior in order to prevent development of a longterm pattern of antisocial behavior. Parents skills training and increased parental monitoring are important elements. It is necessary to get support from parents and the school system since bullies get rewards from their negative behavior.

Keywords: *Bullying, antisocial, short and long – term impact, intervention.*

Hyrje

Konfliktet midis bashkëmoshatarëve duke përfshirë dhe bulizmin, agresionin indirekt dhe dhunën fizike janë fenomene që shfaqen që në ciklin parashkollor, veçanërisht që në kopësht¹. Bulizmi është mesatarisht një fenomen mjaft i përhapur i ditëve shkollore. Studimi empirik i bulizmit është relativisht një fushë e re dhe është pjesë e kategorisë së gjërë të studimit të agresionit. Siç përshkruhen dhe në DSM – 4 – TR shembuj sjelljesh agresive karakterizojnë tipe të veçanta çrregullimesh psikologjike si çrregullimi nxitës kundërshtues, çrregullimi i defiçitit të vëmendjes, çrregullimi i sjelljes antisociale etj.

¹ N.R.Crick, J. Casas & M. Mosher,. Relational and overt aggression in preschool. *Developmental Psychology*, 33, 1997, 579-588.

Sjellja agresive është aktualisht arsyeja më e shpeshtë pse fëmijët dhe të rinjtë u nënshtrohen shërbimeve psikologjike dhe psikiatrike².

Nga kërkimet e shumta ka dalë konkluzioni se sjellja agresive gjatë fëmijërisë është parashikuese për sjelljet agresive dhe problematike në moshat më të vona. Bulizmi shoqërohet me simptoma depresive, fobi sociale, mospërshtatje sociale dhe vetmi. Ai gjithashtu shoqërohet me marrëdhënie të pakta me bashkëmoshatarët, deri në izolim, vetëvlerësim të pakët dhe rrezik vetëvrasjeje në nivele të lartë, si dhe me sjellje antisociale, sjellje nxitëse kundërshtuese, deficiete të vëmendjes dhe hiperaktivitet.

Ky artikull shkencor trajton një fenomen specifik të sjelljes agresive: poshtërimin e përsëritur dhe sistematik, ndërshkimin, torturimin dhe ngacmimin apo sjelljen e egër të disa fëmijëve midis bashkëmoshatarëve të tyre, d.m.th bulizmin. Ky agresion manifestohet në forma të ndryshme (fizike, verbale dhe/ose varëse).

Kufizimet nga format e tjera të dhunës.

Kategorizimi i bulizmit si një mënyrë specifike e dhunës dhe një formë e veçantë e agresionit, bën të nevojshëm kufizimin nga format e tjera të dhunës.

Koncepti „Agresion“ përcakton normalisht veprime, pas të cilave qëndron qëllimi i qartë për t'i shkaktuar dëm personit tjetër ose për t'i shkaktuar atij vuajtje³. Si rrjedhojë sjellja agresive shkakton lëndim të viktimës.

Megjithatë jo gjithmonë është e sigurt, nëse pas një agresioni qëndron një qëllim. Gjithashtu personi agresiv nuk është gjithmonë detyrimisht i vetëdijshëm për pasojat që do të ketë sjellja e tij ndaj personit tjetër. Megjithatë shumica e ngacmuesve e dinë që agresioni i tyre ndikon në mënyrë të pakëndshme, negative ose lënduese.

Një person, i cili është mësuar të sillet dhe të bindë apo mbizotërojë në mënyrë agresive, jo çdo herë ka qëllimin t'i bëjë keq dikujt. Ai sillet ashtu, pa u menduar fare për pasojat që do t'i shkaktojë tjetrit. Një akt agresioni nuk është detyrimisht rezultat i keqëdashjes, por mund të kryhet në mënyrë të pastër në mënyrë instrumentale. Këtë model e gjejmë dhe tek bulizmi.

Këtu qëllimi primar i veprimit agresiv nuk është dëmtimi direkt i viktimës, por përmirësimi i vetvetes, d.m.th. sigurimi i disa të mirave ose privilegjeve, ose arritja e një statusi të lartë ose superior në grupin e bashkëmoshatarëve. Gjithashtu mund të konstatohet se çdo formë e bulizmit paraqet një mënyrë të veçantë të agresionit, por jo çdo mënyrë e agresionit është bulizëm.

Talljet, grindjet fizike dhe zënkat shfaqen relativisht shpesh mes fëmijëve dhe nuk përcaktohen si episode bulizmi, pasi pjesëmarrësit në këto grindje janë thuajse njësoj të fortë fizikisht dhe psikologjikisht. Konfliktet janë pjesë e jetës së përditshme të fëmijëve dhe ato duhet të kenë mundësinë t'i përballojnë dhe zgjidhin këto konflikte në mënyrën e duhur, të paraqesin, parashatrojnë dhe mbrojnë dhe interesat e tyre. Përjetimi dhe zgjidhja e konflikteve u mundëson gjithashtu fëmijëve të njohin dhe të mësojnë të respektojnë kufijtë e tyre dhe të njerëzve të tjerë. Flitet për bulizëm kur kemi të bëjmë me zotërimin e konflikteve të vazhdueshme midis palëve të pabarabarta. Bulizmi nuk u ofron fëmijëve

² R.S. Griffin & A.M. Gross, Childhood bullying: Current empirical findings and future directions for research. *Aggression and Violent Behavior*,9, 2004, fq379-400

³ R.D.Parke, & R.G. Slaby,(1983). The development of aggression. In P.H. Mussen (Eds.) *Handbook of child psychology*, 1983, New York: John Wiley & Sons. Fq 548-641

mundësi zhvillimi. Konfliktet nuk janë të barabarta me bulizmin dhe bulizmi nga ana tjetër nuk është thjesht një konflikt.

Gjithashtu edhe përlëshjet apo grindjet e përkohshme në formë loje kufizohen nga bulizmi. Në këtë rast bëhet fjalë për një formë tipike dhe të pranueshme të lojës sociale, ("lojë e rrëmujshme"⁴) e cila shërben për matjen e forcës midis miqsh të mirë. Këto përlëshje dhe grindje në formë loje kuptohen si lojë edhe nga vetë fëmijët pjesëmarrës. Alsaker gjithsesi paralajmëron që përlëshjet në formë loje kryhen gjithashtu dhe në situata bulizmi me qëllim që të ngatërrojnë të rriturit. Kështu p.sh një agresor mund t'a përfshijë një viktimë, pa e pyetur atë, në një përlëshje në formë loje, për t'i lënë të kuptojë një të rrituri se bëhej fjalë për një lojë.

Tek fëmijët shfaqen mënyra sjelljesh që qëndrojnë midis kufijve të sjelljeve të pranuar dhe të sjelljeve të padurueshme dhe lënduese. Kështu ekzistojnë përlëshje në formë loje që lëkunden midis shakasë dhe seriozitetit, ose bëhen komente të cilat janë të paqarta nëse janë në formën e shakasë apo vërejtjes.

Argumentet e mësipërme e bëjnë të qartë sa e vështirë mund të jetë, para së gjithash për ata që vëzhgojnë nga jashtë, të bëhet dallimi midis një sjellje të vrazhdët dhe bulizmit.

Lindja e sjelljeve buliste

Ende debatohet nëse sjellja agresive është kryesisht e mësuar dhe kushtëzohet prej faktorëve të ambjentit ose nëse janë faktorët gjenetik ato që luajnë një rol vendimtar në lindjen e agresionit.

Përpjekjet teorike në lidhje me procesin e të mësuarit konkludojnë se sjelljet agresive janë të mësuara nëpërmjet mekanizmave mësimor në përgjithësi që në moshën e fëmijërisë së hershme dhe ato konservohen më tej me kalimin e viteve. Në themel ekzistojnë 4 mekanizma, të cilët mbështeten nga ambjenti social për mësimin dhe konservimin e sjelljeve agresive⁵

- **Të mësuarit në bazë të një modeli:** Eksperienca e interpretuar nëpërmjet vëzhgimit të një modeli agresiv, direkt ose në media.
- **Përforcimi pozitiv:** Fëmija nëpërmjet sjelljes agresive arrin një qëllim të caktuar.
- **Përforcimi negativ:** Nëpërmjet sjelljes agresive fëmija arrin të shmangë një situatë të pakëndshme ose një ngjarje kërcënuese.
- **Toleranca ose moskundërshtimi:** Ndaj sjelljes së fëmijës nuk mbahet asnjë qëndrim, gjë që nga fëmija interpretohet si miratim i heshtur.

E vëzhguar në mënyrë përmbledhëse është e dukshme që faktorët gjenetikë dhe faktorët e ambjentit janë në një marrëdhënie të anasjelltë. Para së gjithash në një model sjelljeje kaq

⁴ A.P. Humphreys, & P.K. Smith, Rough and tumble, friendship, and dominance in schoolchildren: Evidence for continuity and change with age. Child Development, 58, 1987, 201-212.

⁵ A. Bandura, Aggression: A social learning analysis. 1973, Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall.

kompleks si bulizmi merren parasysh ekzistenca e lidhjeve gjenetike, të cilat në përmasa të ndryshme rrisin probabilitetin e shfaqjes së sjelljeve buliste, kur ekzistojnë gjithashtu dhe kushte të tjera me rrezik të lartë⁶.

Diskutohet mjaft nëse bulizmi është një fenomen i lindur apo i mësuar. Ne jemi të lindur me të njejtin kod gjenetik që përcakton rritjen dhe funksionimin tonë. Por a përcaktojnë gjenet tona gjithë jetën tonë, veçanërisht a përcaktojnë ato çdo vendim që ne marrim, apo vendimet tona janë rezultat i mjedisit tonë social? Natyrisht që të dy këto faktorë ndikojnë në mënyrë të ndërsjelltë në vendimet dhe sjelljet tona. Si rrjedhojë aktet buliste janë produkt i gjeneve, dhe i ndërveprimeve tona me ambjentin social, pjesë e të cilit jemi. Në faktorin gjenetik ne nuk kemi shumë mundësi të ndërhyjmë, ndërsa në procesin e mësimin të sjelljeve buliste ne mund të ndikojmë mjaft.

Njohja e fenomenit të bulizmit

Nga vëzhgimet dhe takimet e ndryshme me mësues, psikologë shkollorë, zyrtarë të Drejtorisë Rajonale Arsimore të Elbasanit, kolegë nga OJF të ndryshme, nxënës dhe prindër konstatova se fenomeni i bulizmit është një fenomen shqetësues dhe gjithnjë e në përhapje më masive, por megjithatë pak i trajtuar në mënyrë shkencore.

Duke analizuar kurrikulën e ciklit 9 – vjeçar dhe asaj të shkollës së mesme gjithashtu konstatova se fenomeni i bulizmit nuk është trajtuar aspak në tekstet shkollorë si: Edukata Qytetare, Qytetaria apo Karrirera.

Konkluzione dhe rekomandime

Bulizmi është një fenomen i përhapur dhe problematik në shoqërinë tonë. Nxënësit kryesisht konsiderojnë si sjellje të gabuara, ato sjellje që kritikohen dhe dënohen nga bashkëmoshatarët apo nga figurat autoritare. Duke patur parasysh faktin që shumë akte buliste nuk perceptohen si të tilla nga bashkënxënësit, dhe veçanërisht nga mësuesit dhe prindërit, shumë nga këto akte nuk kritikohen apo nuk dënohen. Si rrjedhojë nxënësit i perceptojnë këto akte buliste si të pranueshme dhe vazhdojnë t'i kryejnë ato dhe në të ardhmen.

Si pasojë e literaturës së pakët në lidhje me fenomenin e bulizmit, evidentimi i akteve buliste, parandalimi, zbutja dhe trajtimi i këtyre akteve nuk ndodh në kohën dhe në mënyrën e duhur.

Duke patur sa më shumë informacion shkencor rreth bulizmit, natyrisht që mësuesit, psikologët shkollor, prindërit etj do të jenë më të aftë t'a trajtojnë në mënyrën e përshtatshme këtë fenomen. Nëse ky fenomen shqetësues do të trajtohej më seriozisht, pasojat psikologjike të fëmijëve të përfshirë në bulizëm do të jenë më buta. Natyrisht si objektiv kryesor afatgjatë si i prindërve, mësuesve, psikologëve dhe mbarë komunitetit duhet të jetë konstatimi dhe trajtimi sa më i hershëm, veçanërisht parandalimi i akteve dhe pasojave psikologjike të bulizmit. Kjo do të ishte një mundësi për sigurimin e mirëqenies psikologjike aktuale dhe të mëtejshme të individëve.

Natyrisht që të arrihet trajtimi dhe parandalimi i akteve buliste kërkohet një bashkëpunim midis nxënësve, mësuesve, prindërve, psikologëve shkollorë dhe komunitetit. Në këtë drejtim duhet të ndërmerren programe ndërhyrëse, të cilat mund të përfshijnë dhënie

⁶B. Blanz, Biologische Korrelate aggressiven Verhaltens. Zeitschrift für Kinder- und Jugendpsychiatrie und Psychotherapie, 26, 43-52.

literature bashkëkohore, aktivitete sociale dhe mësimore në kuadër të sensibilizimit të shoqërisë dhe parandalimit të akteve buliste.

Bibliografia

Alsaker, F.D. (1997). Was wissen wir über das Plagen im Kindergarten? Erste Resultate aus Norwegen und der Schweiz (Berichtserie Nr. 1 des NFP40 Projekts „Das Plagen im Kindergarten“)Universität Bern, Institut für Psychologie, Schweiz.

Bandura, A. (1973). *Aggression: A social learning analysis*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall.

Boivin, M., Hymel & Bukowski, W.M. (1995). The roles of social withdrawal, peer rejection, and victimization by peers in predicting loneliness and depressed mood in childhood. *Development and Psychopathology*, 7, 765-785.

Carney, A.G. & Merrell, K.W. (2001). Bullying in schools: Perspective on understanding and preventing an international problem. *School Psychology International*, 22(3), 364-382.

Olweus, D. (1991). Bully/victim problems among school children: Basic facts and effects of a school based intervention program. In D. Pepler & K. Rubin (Eds.), *The development and treatment of childhood aggression* (pp. 411-484). Hillsdale, NJ: Erlbaum.

Salmivalli, C., Lagerspetz, K., Björkqvist, K., Östermann, K. & Kaukiainen, A. (1996). Bullying as a group process: Participant roles and their relations to social status. *Aggressive Behavior*, 22, 1-15.